



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 21.08.2013
Nr. 0204 - 1108

PËR: Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës së Vushtrris
Habib Mustafa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrris

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES TË KOMUNËS
SË VUSHTRRIS, 01 Nr. 186/13, Pranuar me datë, 16.08.2013**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores 01 Nr. 186/13, të miratuar me datë 25.07.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Rregullorja 01 Nr. 186/13, për Dhënien e Dekoratave në Komunën e Vushtrris.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 21.08.2013

br. 0204 - 1108

Za: Bajram Mulaku, Gradonačelnik opštine Vučitrn
Habib Mustafa, Predsedavajući Skupštine opštine Vučitrn

Predmet: Potvrda zakonitosti uredbe opštine Vučitrn
01 Br. 186/13, Primijeno dana, 16.08.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja uredbe 01 br. 186/13, odobreno dana 25.07.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa Zakonom o Lokalnoj Samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je, kao što sledi,

- Uredba 01 br. 186/13, o Davanju Nagrada u Opštini Vučitrn.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVES VLADAVOSHOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data
 Datum 16.08.2013
 Date

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Dhjetja	Vlera
- II -	003-009		

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVES VLADAVOSHOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

At. Nr. 186/13

Nr. i L. -10-

Data e Dërgimit 25.07.2013

VESHITIMI - VESTING



**REPUBLIKA E KOSOVËS
 KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**RREGULLORE
 PËR DHËNIEN E DEKORATAVE**

KORRIK 2013

Bazuar në nenin 12.2 "c" dhe nenin 40.2 "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040, si dhe nenit 41.2 "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 23.07.2013 miraton këtë:

RREGULLORE PËR DHËNIEN E DEKORATAVE

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është themelimi i bazës juridike dhe përcaktimi i llojit të dekoratës, i dhënies dhe revokimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, për qytetarët e Republikës së Kosovës, personat juridik, qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për merita të veçanta ndaj Komunës së Vushtrrisë dhe interesave të saj.

Neni 2 Fushëveprimi

- 2.1. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret për dhënien dhe revokimin e dekoratave nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, si dhe të drejtat dhe detyrat e të dekoruarve;
- 2.2. Të gjitha dekoratat në emër të komunës i ndan Kuvendi i Komunës, i nënshkruan dhe i jep kryetari i komunës sipas dispozitave të kësaj rregulloreje;
- 2.3. Institucionet e tjera të komunës, po ashtu mund të japin mirënjohje apo falënderime nën titullin e tyre, të nënshkruara nga drejtori i institucionit që jep mirënjohje apo falënderime dhe të vulosura me vulën e institucionit përkatës;
- 2.4. Këto institucione janë të obliguara të mbajnë evidencë, protokoll ose regjistër të veçantë me të gjitha shënimet për lëshimin e tyre.

Neni 3 Përkufizimet

- 3.1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 3.1.1. **Dekoratë** - titulli "Qytetar nderi", titulli "Nderi i qytetit", çmimi "Hasan Prishtina", çmimi "Lutfi Musiqi", çmimi "Rrustern Hyseni", çmimi "Poeteshat shqiptare", çmimi "Bereqeti" mirënjohje "Pena e artë", medalje "Sportist i vitit", mirënjohje dhe falënderime;
 - 3.1.2. **Revokim i dekoratës** - heqja e së drejtës dikujt, për bartjen e dekoratës së dhënë.

KREU II DEKORATAT

Neni 4 Llojet e dekoratave

- 4.1. Lloje të dekoratave sipas kësaj rregulloreje janë:
- 4.1.1. titulli "Qytetar nderi",
 - 4.1.2. titulli "Nderi i qytetit",
 - 4.1.3. çmimi "Hasan Prishtina",
 - 4.1.4. çmimi "Lutfi Musiqi",
 - 4.1.5. çmimi "Rrustem Hyseni",
 - 4.1.6. çmimi "Poeteshat shqiptare",
 - 4.1.7. çmimi "Sofra jonë",
 - 4.1.8. mirënjohje "Pena e artë",
 - 4.1.9. medalje "Sportisti i vitit",
 - 4.1.10. çmimi "Emblema e Vushtrisë",
 - 4.1.11. mirënjohje dhe falënderime.

Neni 5

Titulli "Qytetar nderi"

- 5.1. Titulli "Qytetar nderi" është titulli më i lartë që u jepet personaliteteve të shquara politike, shoqërore, shkencore, letrare dhe artistike, në shenjë respekti, miqësie apo mirënjohjeje për kontribute të rëndësishme e të veçanta në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve të Vushtrisë;
- 5.2. Titulli "Qytetar nderi" u jepet edhe personaliteteve të ndryshme, të cilat në kohët më të vështira ndihmuan rrugëtimin e popullit të Kosovës dhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për liri dhe pavarësi;
- 5.3. Titulli "Qytetar nderi", nuk u jepet qytetarëve të Komunës së Vushtrisë;
- 5.4. Titulli përbëhet nga një "çelës", i cili simbolizon çelësin e portës së komunës, si dhe një fletëpërcjellje;
- 5.5. Çelësi ka gjatësi 30 cm, ngjyrë ari, në të cilin shkruhet emri dhe mbiemri i personit që i jepet titulli, i shkruar me shkronja të gravuara në pjesën e dorëzës dhe teksti "Qytetar nderi" i Komunës së Vushtrisë;
- 5.6. Fletëpërcjellja është një letër e cilësisë së lartë e formatit A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrisë;
- 5.7. Në pjesën e sipërme të fletës shkruan: Komuna e Vushtrisë shpall "Qytetar nderi" znj-z.(emri dhe mbiemri, vendbanimi, komuna, shteti). Po ashtu në fletë shkruhet numri i protokollit dhe data, ndërsa në fund të fletës në anën e djathtë, shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;
- 5.8. Titullin "Qytetar nderi" e jep kryetari i komunës në mbledhje solemne të Kuvendit, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës.

Neni 6

Titulli "Nderi i qytetit"

- 6.1. Titulli "Nderi i qytetit" është dekorata më e lartë që u jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Vushtrrisë që kanë dhënë kontribute të veçanta dhe shumë të rëndësishme, të cilat kanë lartësuar emrin e qytetit, që kanë një veprimtari të gjerë dhe të rëndësishme në dobi të qytetarëve, vlera të veçanta e të njohura edhe në rrafshin kombëtar dhe që janë personalitete të rëndësishme në fusha të veçanta të shoqërisë, shkencës, artit dhe sportit, që kanë formuar një figurë të pastër dhe që kanë cilësi të larta njerëzore;
- 6.2. Ky titull u ndahet atyre qytetarëve që realizojnë akte të larta humanizmi, heroizmi dhe sakrifice;
- 6.3. Titulli përbëhet nga plaketa dhe fletëmirënjohja.
- 6.4. Plaketa ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz e praruar në ar, me diametër 7 cm në mesin e së cilës gjendet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, ndërkaq nën të shkruhet emri dhe mbiemri i fituesit, kurse në pjesën e poshtme të saj shkruhet data e dhënies.
- 6.5. Fletëmirënjohja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë e formatit A4 dhe në sfondin e fletës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: Komuna e Vushtrrisë shpall "Nderi i qytetit" i Vushtrrisë" z.(emri dhe mbiemri). Në fletë shkruhet numri i protokollit dhe data, ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë, shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;
- 6.6. Kryesuesi i kuvendit e lexon vendimin e kuvendit mbi shpalljen "Nderi i qytetit" dhe e thërret kryetarin e komunës për dhënien e titullit;
- 6.7. Titullin "Nderi i qytetit" e jep kryetari i komunës në mbledhje solemne të Kuvendit, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës;
- 6.8. Titulli shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve, në vlerë prej 1000 Euro.

Neni 7

Çmimi "Hasan Prishtina"

- 7.1. Çmimi "Hasan Prishtina" është dekorata më e lartë që u jepet personaliteteve të shquara shqiptare në shenjë nderi dhe respekti për kontributin e dhënë në çështjen kombëtare, në fushën e shkencës, kulturës artit dhe letërsisë e që janë të ftuar të nderit në manifestimet "Ditët e Hasan Prishtinës";
- 7.2. Ky çmim është i veçantë dhe ndahet vetëm në manifestimet tradicionale "Ditët e Hasan Prishtinës";
- 7.3. Çmimi përbëhet nga portreti i Hasan Prishtinës dhe një fletëpërcjellje;
- 7.4. Portreti ka formë rrethi, është i punuar në bronz, i praruar në ar, me diametër 10 cm, në mesin e të cilit gjendet portreti i Hasan Prishtinës dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, ndërkaq nën të shkruhet emri, mbiemri i fituesit, titulli "Ditët e Hasan Prishtinës" dhe viti i mbajtjes;

- 7.5. Fletëpërcjellja shkruhet në letër të cilësisë së lartë, formati A 4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;
- 7.6. Në pjesën e sipërme të fletëpërcjelljes shkruan: Komuna e Vushtrrisë ndan çmimin "Hasan Prishtina" z. (emri dhe mbiemri i fituesit të shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti);
- 7.7. Në fletëpërcjellje shkruhet edhe numri i protokollit e në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;
- 7.8. Kryesuesi i kuvendit e lexon vendimin e Kuvendit mbi ndarjen e çmimit dhe e thërret kryetarin e komunës për dhënien e çmimit;
- 7.9. Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës në manifestimin "Ditët e Hasan Prishtinës";
- 7.10. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 Euro.

Neni 8

Çmimi "Lutfi Musiqi"

- 8.1. Çmimi "Lutfi Musiqi" është dekoratë e veçantë dhe u jepet studentëve dhe hulumtuesve të shkencave teknike, që janë barorë të Vushtrrisë apo kanë kontribuar për Komunën e Vushtrrisë dhe ndahet një në vit;
- 8.2. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, në të cilën shkruan: Për suksese të veçanta në fushën e shkencave teknike, Komuna e Vushtrrisë jep çmimin "Lutfi Musiqi" z-znj. (emri dhe mbiemri), ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;
- 8.3. Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij;
- 8.4. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 Euro.

Neni 9

Çmimi "Rrustem Hyseni"

- 9.1. Çmimi "Rrustem Hyseni" është dekoratë e veçantë dhe u jepet studentëve dhe hulumtuesve të shkencave shoqërore, që janë banorë të Vushtrrisë apo kanë kontribuar për Komunën e Vushtrrisë dhe ndahet një në vit;
- 9.2. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë, formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe në të cilën shkruan: Për suksese të veçanta në fushën e shkencave shoqërore, Komuna e Vushtrrisë jep çmimin "Rrustem Hyseni" z-znj.(emri dhe mbiemri), ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës, kurse në mes të fletës jepet vula e komunës;

9.3. Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij;

9.4. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 Euro.

Neni 10

Çmimi "Poeteshat shqiptare"

10.1. Çmimi "Poeteshat shqiptare" është dekoratë e veçantë dhe i jepet poeteshës, poezia e së cilës shpallet më e mira në orën e madhe letrare në takimin e Poeteshave Shqiptare;

10.2. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje;

10.3. Fletëpërcjellja shkruhet në letër të cilësisë së lartë, formati A 4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;

10.4. Në pjesën e sipërme të fletëpërcjelljes shkruan: Komuna e Vushtrrisë ndan çmimin "Poeteshat shqiptare" znj.(emri dhe mbiemri i fitueses së shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti);

10.5. Në fletëpërcjellje shkruhet edhe numri i protokollit, kurse në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;

10.6. Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij;

10.7. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 Euro.

Neni 11

Çmimi "Sofra jonë"

11.1. Është dekoratë e veçantë dhe u jepet bujqve, blegtorëve, pemëtarëve, bletarëve, kopshtarëve dhe të gjithë prodhuesve të tjerë të Komunës së Vushtrrisë, në shenjë mirënjohje dhe respekti për kontributin e tyre në zhvillimin e ekonomisë së komunës;

11.2. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje;

11.3. Fletëpërcjellja shkruhet në letër të cilësisë së lartë, formati A 4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;

11.4. Në pjesën e sipërme të fletëpërcjelljes shkruan: Komuna e Vushtrrisë ndan çmimin "Sofra jonë" z-znj.(emri dhe mbiemri i fituesit të shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti), për suksese të arritura në prodhimin e.....;

11.5. Në fletëpërcjellje shkruhet edhe numri i protokollit, ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;

11.6. Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij;

11.7. Çmimi ndahet një herë në vit dhe jepet në rastin e "Festës së Patates";

11.8. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 Euro.

Neni 12

Çmimi "Pena e artë"

12.1. Titulli "Pena e artë" u jepet artistëve të shquar dhe personaliteteve më të rëndësishme të arsimit, artit, shkencës dhe kulturës për aktivitete të evidencuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar, të vlerësuar me tituj, urdhra e medalje për veprimtarinë e tyre krijuese e interpretuese, që kanë një personalitet të pastër qytetarie dhe që gëzojnë popullaritet;

12.2. Titulli përbëhet nga plaketa dhe një fletëpërcjellje;

12.3. Plaketa ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz, e praruar në ar, me diametër 10 cm, në mesin e së cilës gjendet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, kurse në qendër të saj me ngjyrë ari shkruan "Pena e artë", ndërkaq në fund shkruan emri, mbiemri dhe viti i të dekoruarit;

12.4. "Pena e artë" shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë, formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, në të cilën shkruan: Për merita të veçanta (fusha e kontributit), Komuna e Vushtrrisë jep titullin "Pena e artë" z-znj.(emri dhe mbiemri), ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;

12.5. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 Euro;

12.6. Gjatë një viti kalendarik ky çmim mund të ndahet vetëm njëherë;

12.7. Iniciativat për dhënien e këtij titulli mund të bëhen nga institucionet komunale, arsimore, kulturore, sportive, grupet e qytetarëve dhe shoqëria civile.

Neni 13

Medalje "Sportisti i vitit"

13.1. Medalje "Sportisti i vitit" u jepet sportistëve të shquar për kontribute të veçanta në lëmin e sporteve;

13.2. Medalja ka diametër 5 cm, në pjesën e lartë nën rreth shkruhet: Komuna e Vushtrrisë, më poshtë shkruhet me ngjyrë ari: "Sportisti i vitit" dhe në pjesën e fundit shkruhet viti i marrjes së medaljes;

13.3. Medalja shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe në të cilën shkruan: Për suksese të veçanta në... (lloji i sportit), Komuna e Vushtrrisë jep medaljen "Sportisti i vitit" z-znj. (emri dhe mbiemri), ndërsa në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;

13.4. Medaljen e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij;

13.5. Çmimi shoqërohet edhe me një shumë të mjeteve që i cakton kryetari i komunës, por jo më shumë se 500.00 €uro;

13.6. Në një vit kalendarik medalje "Sportisti i vitit" mund t'i jepet vetëm një fituesi;

13.7. Iniciativat dhe propozimet për dhënien e kësaj medaljeje duhet të bëhen nga institucionet e sportit, klubet sportive, shoqatat sportive, grupe sportistësh apo qytetarësh që përfaqësojnë nivelet më të gjera të komunitetit dhe që shoqërohen me biografi përkatëse, dokumente, dëshmi dhe vlerësime të nevojshme të veprimitarisë së personalitetit të propozuar.

Neni 14

Mirënjohjet dhe falënderimet

14.1. "Mirënjohjet dhe falënderimet u jepen në shenjë respekti atyre personaliteteve, të cilat kanë dhënë një kontribut të veçantë, të dallueshëm dhe të rëndësishëm në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve;

14.2. Mirënjohja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë, me dimension A 4, në sfondin e fletës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: Komuna e Vushtrrisë jep mirënjohje apo falënderim z.-zrj.(emri dhe mbiemri i fituesit të shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti), kurse në fletëmirënjohje shkruhet numri i protokollit, ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës;

14.3. Mirënjohjet dhe falënderimet i jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij.

Neni 15

Dhënia e dekoratave

15.1. Dekoratat u jepen individëve dhe personave juridik, në përshtatje me kontributet dhe vlerat, rolin dhe ndikimin e tyre në opinionin publik;

15.2. Dekoratat mund t'u jepen qytetarëve të Republikës së Kosovës, personaliteteve të njohura publike, personave juridik dhe subjekteve tjera;

15.3. Dekoratat mund t'u jepen qytetarëve edhe pas vdekjes;

15.4. Dekoratat mund t'u jepen shtetasve të huaj, personaliteteve të njohura botërore dhe organizatave ndërkombëtare;

15.5. E njëjta dekoratë nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtit person.

Neni 16

Propozimet për dekorata

16.1. Propozimin për ndarjen e titullit "Qytetar nderi" dhe "Nderi i qytetit" mund ta bëjnë kryetari i komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe së paku 1/3 e këshilltarëve të Kuvendit Komunal;

16.2. Iniciativën për dhënien e këtij titulli mund ta jep cilido institucion i komunës, secili këshilltar i Kuvendit ose së paku, 700 qytetarë të Komunës së Vushtrrisë;

16.3. Propozimin për dekoratën "Hasan Prishtina", mund ta bëjnë kryetari i komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa, secili nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë apo iniciativa qytetare me 100 nënshkrime;

16.4. Propozimin për dekoratën "Lutfi Musiqi" dhe "Rrustem Hyseni" mund ta bëjnë; institucionet e arsimit, Drejtoria Komunale e Arsimit, kryetari i komunës; anëtarët e kuvendit, Komiteti Konsultativ për Arsim;

16.5. Të propozuarit për dekorim duhet të kenë arritje, kontribut dhe vlera të veçanta në shërbim të shoqërisë dhe të vendit.

Neni 17

Shqyrtimi i propozimeve

17.1. Kryetari i komunës në çdo fillim viti kalendarik e formon komisionin për shqyrtimin e propozimeve dhe iniciativave për dekorata me mandat njëvjeçar me përbërje x anëtarë nga Administrata e komunës;

17.2. Të gjitha propozimet për dekorata i adresohen komisionit për dekorata;

17.3. Komisioni bën përzgjedhjen paraprake dhe i propozon listën e ngushtë Kuvendit të Komunës për miratim;

17.4. Kuvendi i Komunës merr vendim për ndarje të dekoratave me propozim të komisionit;

17.5. Nëse konstaton anime dhe parregulsi në punën e komisionit, Kuvendi mund të vendosë ndryshe nga propozimi i komisionit;

17.6. Çdo propozim duhet të jetë i arsyetuar me shkrim para komisionit, ndërsa kryetari i komisionit propozimet e komisionit i arsyeton me shkrim dhe me gojë para kuvendit;

17.7. Vendimet e Kuvendit për ndarje të dekoratave i nënshkruan kryesuesi i kuvendit sipas procedurave të kuvendit;

17.8. Të gjitha dekoratat të cilat i ndan Kuvendi, i nënshkruan kryetari i komunës, ndërsa vendimin për dekorata e nënshkruan kryesuesi i kuvendit.

KREU III

DISPOZITAT E PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Revokimi i dekoratave

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë rezervon të drejtën e revokimit të dekoratave, në raste të veçanta kur fituesit e tyre dënohen për vepra të rënda penale.

Neni 19

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Rregullorja hyr në fuqi tetë ditë pas nënshkrimit nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrisë dhe publikimit të saj në faqen e internetit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa
Habib Mustafa